



## **PËRMBLEDHJE E TAKIMIT TË PUNËS**

### **HYRJA**

Takimi i punës (workshop) për Vlerësimin e Performancës së shtatë Kompanive Regjionale të Ujit në 2008 është mbajtur me 04 Qershor 2009 në Villa Germia në Prishtinë.

Takimi i punës është organizuar nga Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina, mbështetur nga Projekti WM-OFMP (financuar nga SDC). Projekti i WM-OFMP i kushton vëmendje të posaçme transferimit të planifikuar mirë dhe të qëndrueshëm të njohurive tek ZRRUM, duke ruajtur ekspertizën esenciale në vend, në të mirë të tërë sektorit të ujit në Kosovë.

Seminarin e kanë ndjekur rreth 40 përfaqësues nga Ujësjetës, Komuniteti i Donatorëve, Instituti i Shëndetit Publik, SHUKOS, Përfaqësues nga Shqipëria dhe Maqedonia.

Në këtë takim pune ZRRUM dhe Konsulentja e WM-OFMP kanë paraqitur:

- Vlerësimin e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara nga të shtatë Kompanitë Regjionale të Ujit.
- Vlerësimin e performancës vjetore të sektorit në përgjithësi dhe të shtatë Kompanive Regjionale të Ujit në Kosovë gjatë vitit 2008.
- Shpalljen e Kompanisë me performancën më të mirë në vitin 2008 dhe të Kompanisë me përmirësimet më evidente gjatë vitit 2008 në krahasim me vitin 2007.
- Promovimin e idesë për krijimin e Rrjetit të Benchmarkingut Regjional.

Përveç ZRRUM dhe Konsulentës, takimi në fjalë ka arritur të tërheqë dy ekspertë të tjerë të ujit që të prezantojnë Vlerësimin e Performancës së Sektorit të Ujit në Shqipëri dhe Maqedoni. Pjesëmarrësit me këtë rast kanë mundur të krijojnë një përshtypje se si performojnë ujësjetës në regjion.

## **AUDITIMI I TË DHËNAVE TË RAPORTUARA**

Përmes prezantimit të Z. Qamil Musa, pjesëmarrësit kanë patur mundësinë të njihen me çështjet e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara nga shtatë Kompanitë Regjionale. Rezultatet e auditimit u janë referuar verifikimit të të dhënave në terren nga ZRRUM në fillim të vitit 2009.

Duket se saktësia dhe besueshmëria e të dhënave janë plotësisht të lidhura me sistemin informatik të menaxhmentit. Rekomandohet që ka ende disa çështje për t'u zgjidhur në modulet ekzistuese (Faturimi dhe Kontabiliteti), ndërsa modulet e reja (siç janë Relacionet me Konsumatorë dhe GIS) duhet të zhvillohen dhe t'i shtohen sistemit ekzistues informatik të menaxhmentit të kompanive.



## **VLERËSIMI I PERFORMANCËS VJETORE TË SHTATË KOMPANIVE REGJIONALE NË 2008**

Gjatë 1 ½ të vitit të fundit, Znjsh. Vera Muhaxhiri, Konsulentja e WM-OFMP e ka mbështetur ZRRUM gjatë mbledhjes së të dhënave, auditimit dhe vlerësimit të performancës së Kompanive të Ujit.

Gjatë prezantimit të saj, Znjsh. Muhaxhiri ka dhënë një pasqyrë të performancës absolute dhe relative të sektorit të ujit dhe të kompanive individualisht. Ajo gjithashtu ka treguar radhitjen e performancës prej më të mirës deri në më të dobtën përmes treguesve kryesor të performancës, ku ishte e mundshme që kompanitë t'i shohin dallimet në performancë.

Duke ofruar qasje te informacionet krahasuese, Menaxhmentet e Kompanive mund t'i identifikojnë fushat e tyre të dobëta, ku duhet t'i adresojnë përmirësimet dhe ku duhet të adoptohen caqet reale. Në të njëjtën kohë, Qeveria mund të monitorojë dhe të rregullojë politika dhe programe për sektorin, ndërkohë që Rregullatori mund të sigurojë që konsumatorët pranojnë shërbime të mira.



Në këtë mënyrë, monitorimin e performancës Konsulentja e ka konsideruar si instrument për angazhimin e të gjitha palëve të interesit. Bazuar në rezultatet e performancës të 2008, ZRRUM së bashku me Konsulentin kanë vendosur të mbajnë takime pune me secilën kompani veçmas

(në lokacionet e tyre) për të gjetur se çka e pengon progresin dhe se çka duhet bërë për ta ndaluar pengesën në mënyrë që t'i përmirësojnë performancat e tyre.

Përveç kësaj, Raporti i ardhshëm i Performancës për 2008 do të na japë një analizë të mëtutjeshme për performancën e shtatë Kompanive Regjionale.

## **METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS DHE SHPALLJA E KOMPANISË MË TË MIRË PERFORMUESE NË 2008 DHE KOMPANIA ME PËRMIRËSIMET MË TË MIRA**

Znjsh. Muhaxhiri mendon se verifikimi i të dhënave të raportuara tek ZRRUM mbulohet në mënyrë efektive nga auditimi vjetor. Të dhënat e audituara, pastaj, janë përdorur gjatë përpunimit të treguesve të performancës dhe së fundmi vlerësimit të performancës.

Siç është thënë gjatë prezantimit, në vlerësimin e performancës në të kaluarën, mungesa e shkallëzimit të besueshmërisë së kualitetit të të dhënave ka paraqitur një hendikep domethënës gjatë fazës së analizimit. Nën këto rrethana, konkluzionet e analizës përfundimtare patjetër që kanë mundur të jenë të dyshimta.

Vlerësimi i performancës së kompanive është bërë përmes metodës së klasifikimit.

Me vlerësimin e performancës të radhitur në bazë të metodologjisë së analizës së kualitetit, ne besojmë se publikimi i këtyre analizave do të ketë ndikim në përmirësimin e performancës në përgjithësi të ujësjellësve dhe si rezultat përmirësimin e shërbimeve të ofruara tek konsumatorët.

Si rezultat i këtij vlerësimi është shpallur kompania me performancën më të mirë gjatë 2008 dhe kompania me përmirësimet më të dukshme në 2008 krahasuar me 2007.

***Z. Afrim Lajçi, Drejtor Gjeneral i ZRRUM e ka shpallur KUR 'Prishtina' sh.a. si kompaninë me performancën më të mirë në 2008.***

Kjo është përcjellur me një çmim simbolik prej €2,500 që është dhënë nga Z. Guido Beltrani, Zv.Drejtor i SCO për Z. Skender Bublaku, Drejtor Menaxhues i KRU 'Prishtina'.



**Z. Afrim Lajçi, Drejtor Gjeneral i ZRRUM e ka shpallur KUR 'Hidrodrini' sh.a. si kompaninë me përmirësimet më evidente gjatë vitit 2008 krahasuar me 2007.**

Çmimi simbolik prej €1,000 i është dhënë Z. Agron Tigani, Drejtor Menaxhues i KRU 'Hidrodrini' nga Z. Guido Beltrani, Zv.Drejtor i SCO.



### **KRAHASIMI I PERFORMANCËS SË SEKTOREVE TË UJIT NË REGJION (SHQIPËRI DHE MAQEDONI) DHE IDEA E BENCHMARKINGUT REGJIONAL**

Znj. Jani (përfaqësuese e Shqipërisë), Z. Ristovski (përfaqësues i Maqedonisë) dhe Zsh. Muhaxhiri (përfaqësuese e Kosovës) në prezantimet e tyre të ndara i kanë shpjeguar përfitimet nga krijimi i Rrjetit të Benchmarkingut Regjional. Qëllimi i kësaj pjese të takimit të punës ishte fillimi i ngritjes së një dialogu në regjion për monitorimin dhe përmirësimin e performancës përmes shkëmbimit të treguesve të performancës. Sigurisht që ka nevojë të madhe për ta përmirësuar menaxhmentin dhe bashkëpunimin në nivelin e ujësjellësve, nivelin lokal dhe regjional. Përveç kësaj, mund të konsiderohet si obligim i plotësimit të standardeve dhe Direktivave të BE.

Në këtë shkallë, Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova e kishin mundësinë t'i ndanin përvojat përmes paraqitjes së vlerësimit të performancës së sektorëve të ujit të secilit vend.

Deri në këtë moment, janë krijuar dhe janë aktive programet e monitorimit, në Shqipëri dhe Kosovë dhe një program që është zhvilluar dhe që mund të vazhdohet në Maqedoni.



Përfaqësuesja nga Shqipëria e ka përshkruar historikun e Programit Monitorues dhe i ka paraqitur rezultatet e vlerësimit të performancës së sektorit të ujit në Shqipëri në vitin 2008.

Përfaqësuesi nga Maqedonia ka treguar se si funksionon struktura institucionale e sektorit të ujit në Maqedoni dhe ka paraqitur rezultatet e vlerësimit të performancës së 2002-2007 të 15 ujësjellësve të Maqedonisë.



Përfaqësuesit e tri shteteve janë pajtuar se për krijimin e rrjetit të benchmarkingut ka nevojë të standardizohen definicionet e treguesve të performancës, të publikohen dhe të ndahen informacionet e performancës dhe së fundmi, të kalohet prej monitorimit të performancës te përmirësimi i performancës.

## **REKOMANDIME**

ZRRUM është i bindur se Kompanitë e Ujit mund të veprojnë më shumë në përmirësimin e performancës operative, financiare dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve me mbështetjen e plotë të të gjithë akterëve të ujit që janë aktiv në Kosovë.

Për këtë arsye, fushat më urgjente që kanë nevojë për vëmendje janë këto në vazhdim:

- Matja e saktë e ujit të prodhuar dhe të konsumuar.
- Zbulimi i kyçjeve ilegale
- Zvogëlimi i humbjeve të ujit
- Rritja e arkëtimit
- Mirëmbajtja e rrjetit
- Zhvillimi i mëtutjeshëm i Sistemit Informatik të Menaxhmentit
- Zhvillimi i mëtutjeshëm i Zyrës për Marrëdhënie me Konsumatorë

**\*\*\***

*Të gjitha prezantimet e takimit të punës mund t'i gjeni të bashkangjitura me letrën përmbledhëse dhe do të publikohen së shpejti përmes webfaqes së ZRRUM [www.wvro-ks.org](http://www.wvro-ks.org).*

## **NË FUND:**

**TË GJITHË MUND TË BËJMË MË SHUMË PËR UJIN, QË TË KEMI UJË PËR TË GJITHË!**